



Pranuar / Dorezuar Priljezim/Prilato Received/Delivery	08.08.2022	viti god year	
Organ /Rjeshtja Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPJENI	4604/19022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.638/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Malësore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.638/2022 të datës 21.07.2022 të parashtruar ankuesi me adresë banimi në Prishtinë, kundër Vendimit KD.Nr.011,012,013/2022 të datës 22.06.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.08.2022, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.638/2022 e datës 21.07.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KD.Nr.011,012,013/2022 i datës 22.06.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 21.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 4223/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KD.Nr.011,012,013/2022 të datës 22.06.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave procedurale dhe shkelje thelbësore të së drejtës materiale(ligjit).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosje në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 4223/2022 të datës 21.07.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KD.Nr.011,012, 013/2022 të datës 22.06.2022

të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin A.nr.377/2022 i datës 27.05.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Fletë kthesën e datës 24.06.2022; Vërtetimin e datës 14.06.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 27.07.2022; Ankesën me numër protokolli 2111/2022 të datës 14.04.2022 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KD.nr.011,012,013 të datës nga Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 0139 të datës 11.02.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 1187 të datës 20.10.2021 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Formën e përmbajtjes së dokumenteve në dosje nga oficeri të datës 21.01.2011; Vendimin e datës 20.01.2016 nga Drejtori i BSL-së; Thirrjen për intervistë të datës 12.01.2016; Inicimin e procedurës disiplinore për të datës 23.12.2015; Propozimin për masën disiplinore të datës 19.01.2016 për Vendimin e datës 12.01.2016 nga Drejtori i BSL-së; Intervistën e datës 13.01.2016 për Deklaratën e datës 12.12.2015 nga Raportin e datës 12.12.2015 nga Deklaratën e datës 18.12.2015 nga Deklaratën e datës 12.12.2015 nga dhe Shkresën mbi orarin e oficerëve për ndërrimin e natës për datat 17-18.12.2015; Vendimin me numër 0202 të datës 18.02.2022 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Shkresën zyrtare të datës 22.12.2021 lidhur me inspektimin për beneficionet e të burgosurit F.M në BSL; Vërtetimin e datës 22.03.2022; Vërtetimin e datës 11.03.2022; Shkresën zyrtare me numër 0124 të datës 08.02.2022 lidhur me inicimin e procedurës disiplinore për ankuesin Vendimin me numër KD.nr.011.012.013 të datës 09.03.2022, nga Komisioni Disiplinor lidhur me shtyrjen e afatit për vendosje; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 04.05.2022 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit e nëpunësit të datës 05.03.2013; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar të datës për nëpunësin Akt emërimit e nëpunëses të datës 21.10.2014; Kontratën e punës së ankuesit të datës 16.02.2018; Kontratën e punës së ankuesit të datës 03.01.2019; Vendimin me numër 4182 të datës 14.11.2019 nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Akt emërimit e ankuesit të datës 06.12.2017 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zëvendës Drejtor në QP-Lipjan; Inicimin e procedurës disiplinore me numër 0124 të datës 08.02.2022 për ankuesin Procesverbalin e datës 16.03.2022, 08.03.2022 lidhur me intervistën e ankuesve; Raportin përfundimtar të hetimeve të datës 07.02.2022 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës; Raportin final të datës 07.02.2022 lidhur me zbardhjen e rastit të realizimit të vizitës së lirë nga i burgosuri F.M në BSL; Vendimin me numër 0089 të datës 31.01.2022 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kërkesën me numër 326 të datës 19.05.2021; Aktgjykimin me numër PS 54/20 të datës 18.02.2020 nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Special; Aktgjykimin me numër APS.nr.1/21 të datës 10.02.2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës; Shkresën zyrtare të datës 11.11.2021 lidhur me llogaritjen e dënimit; Vendimin me numër 747 të datës 08.10.2019 lidhur me formimin e komisionit profesional; Formularin e vlerësimit për beneficione të datës 16.03.2021; Raportet e datës 16.03.2021 për pushimet jashtë burgut; Kërkesën e datës 15.03.2021 lidhur me realizimin e vizitës; Formën e panelit për beneficione të datës 16.03.2021; Formularin e vlerësimit për beneficione të datës 19.03.2021; Raportet e datës 19.03.2021, 22.03.2021 për pushimet jashtë burgu; Certifikatën e martesës së datës 16.03.2021; Formën e panelit për beneficione të datës 22.03.2021; Rivlerësimin për beneficione të datës 30.04.2021; Kërkesën e datës

29.04.2021; Formën e panelit për beneficione të datës 11.05.2021; Rivlerësimin për beneficione të datës 28.06.2021; Kërkesën e datës 21.06.2021; Formën e panelit për beneficione të datës 29.06.2021; Rivlerësimin për beneficione të datës 28.09.2021; Kërkesën e datës 28.09.2021; Formën e panelit për beneficione të datës 28.09.2021; Vendimin e datës 27.10.2020; Njoftimin e datës 23.03.2021, 25.05.2021, 21.07.2021, 28.09.2021; Shkresat zyrtare të datës 24.03.2021, 29.09.2021, 26.05.2021 dhe 21.07.2021; Udhëzimin administrativ me numër MD-NR.07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankuesit
sepse:

Nga administrimi i provave materiale rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën *Drejtori i Burgut të Sigurisë së Lartë* në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Ndaj të njëjtit është iniciuar procedurë disiplinore bazuar në Raportin Nr.0115 të datës 07.02.2022 të Komisionit Hetimor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në bazë të të cilit janë konstatuar shkelje lidhur me realizimin e vizitës së lirë nga i burgosur F.M në Burgun e Sigurisë së Lartë. Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës më datë 23.03.2022 me Vendimin KD.nr.011,012,013/2022 të datës 22.06.2022 ndaj ankuesit ka shqiptuar masën disiplinore *"ndalimi 20% i pagës për periudhën prej një muaj"*. Kundër këtij vendimi ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili pas konstatimit së vendimi i kundërshtuar është i përfshirë më të meta ligjore me Vendimin A.nr.377/2022 të datës 27.05.2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit A.nr.377/2022, ka shfuqizuar Vendimin KD.Nr.011,012,013/2022 të datës 23.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe ka obliguar të njëjtin të rishqyrtoj këtë çështje disiplinore.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës në ri-procedurë më Vendimin KD.Nr.011,012,013/2022 të datës 22.06.2022, ka shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje të rëndë disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe 3.10 në lidhje me nenin 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse, sipas Komisionit Disiplinor ankuesi me aprovimin e kërkesës për vizitë të lirë (qëndrim në lokale të veçanta) vendimi aprovues i datës 28.09.2021 për të dënuarin F.M, duke mos vlerësuar më kujdes çështjen e dhënies së beneficioneve ka aprovuar beneficionet në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, dhe si rrjedhojë Komisioni Disiplinor, ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *"ndalim 20% i pagës për periudhë një muaj"*.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të pretendon që vendimi i kundërshtuar me ankesë është i përfshirë më shkelje thelbësore të dispozitave procedurale dhe materiale, duke shtuar me tej se Komisioni Disiplinor në rishqyrtimin është bazuar në vlerësimin e komisionit paraprak, anëtari i Komisionit Disiplinor nuk mbanë pozitë të mesme drejtuese ashtu siç përcaktohet me nenin 10 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtareve Publikë, Komisioni Disiplinor në mënyrë të kundërligjshme ka klasifikuar shkeljen dhe në mënyrë të kundërligjshme ka shqiptuar masën disiplinore.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se anëtari i Komisionit Disiplinor nuk mbanë pozitë të mesme drejtuese, ju referua nenit 10 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku është përcaktuar se: 2. *Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët duhet të jenë nëpunës civilë, nga të cilët njëri duhet të jetë jurist*

dhe ka këtë përbërje: 2.1. Nëpunës civil i nivelit drejtues – Kryesues i Komisionit; 2.2. Nëpunës civil i nivelit profesional – anëtar dhe 2.3. Nëpunës civil i njësisë së burimeve, dhe si rrjedhojë ka konstatuar së sipas këtyre dispozitave ligjore njeri nga anëtarët e komisionit disiplinor duhet të jetë i nivelit drejtues pa specifikuar nivel të mesëm apo të ulët drejtues, ndërsa nga analizimi i provave materiale gjegjësisht Vendimit me numër protokollit 0139 të datës 11.02.2022 për themelimin e Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, është emëruar në cilësi të kryesuesit të këtij komisioni dhe se i njëjti sipas Akt Emërimit të datës 05.03.2013 ushtron pozitën Udhëheqës i Administratës në Qendrës e Paraburgimit në Prizren, e cila pozitë në kuptim të nenit 33 paragrafi 2 nenparagrafi 2.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë konsiderohet pozitë drejtues e nivelit të ulët, andaj, mbi këto fakte Kolegji i Këshillit konstaton së është i pabazuar pretendimin mbi këtë bazë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e administruara të lëndës, ka gjetur se Komisioni Profesional i themeluar me Vendimin me numër protokollit 747 të datës 08.10.2019 për shqyrtimin e kërkesave për benificione në kuadër të institucionit korrektues, me datë 28.09.2021 ka rekomanduar miratimin e kërkesës së të dënuarit F.M të datës 28.09.2021 për vizitë të lirë, ndërsa ankuesi në cilësinë e Drejtorit të Burgut të Sigurisë së Lart dhe ashtu siç është përcaktuar në pikën III të Vendimit me numër protokollit 747 të datës 08.10.2019, ka miratuar rekomandimin e komisionit duke i lejuar të dënuarit F. M vizitë të lirë më datë 24.09.2021.

Me dispozitat e Udhëzimit Administrativ MD-Nr.07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, konkretisht neni 48, përcaktohet se: 1. Për realizimin e së drejtës në benificion për kalimin e kohës në lokale të veçanta duhet të plotësohen këto kushte: 1.1. shjella e mirë e personit të dënuar gjatë mbajtjes së dënimit; 1.2. të mos jetë shfrytëzues i pushimit jashtë institucionit korrektues. 2. E drejta në benificion për kalimin e kohës në lokale të veçanta mund t'i lejohet personit të dënuar me të paktën dy (2) vjet dënim me burgim që mund të shfrytëzohet vetëm pasi të kenë kaluar gjashtë (6) muajt e parë të dënimit", ndërsa bazuar në provat e lëndës, gjegjësisht Aktgjykimin me numër PS-54/20 të datës 18.12.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special është konstatuar se i burgosuri F.M është shpallur fajtor dhe është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj, dhe i njëjti aktgjykim është vërtetuar me Aktgjykimin me numër APS.nr.1/21 të datës 10.02.2021 të Gjykatës se Apelit në Prishtinë - Departamenti Special.

Bazuar si me sipër, Kolegji konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk janë përmbushur kushtet ligjore për aprovimin e kërkesave për vizatë të lirë në lokale të veçanta sepse i burgosuri F.M ka qenë i dënuar me burgim me pak se dy (2) vjet, gjegjësisht një (1) vit e gjashtë (6) muaj, andaj ankuesi me veprimet e tij duke aprovuar kërkesën e të burgosurit F.M për vizitë të lirë në lokale të veçanta ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 48 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, dhe rrjedhimisht në kundërshtim me nenin 25 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: "2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike", sepse zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij, siç parashihet me nenin 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Andaj, Kolegji vlerëson se ankuesi me rastin e mos përmbushjes së detyrave të punës është përgjegjës për shkeljen e kryer të përcaktuara si në nenin 46 paragrafi 1 dhe 3 nën paragrafi 3.3 dhe

3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që Komisioni Disiplinor lidhur me këtë çështje juridike ka konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe bazën juridike, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 ku përcaktohet se: "1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil", ndërlidhur me nenin 48 paragrafi 3 ku përcaktohet se: "Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor". Rrjedhimisht, Komisioni Disiplinor ka vepruar në pajtim edhe me nenin 50 paragrafin 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 13 paragrafin 3, 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, si dhe nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe në këtë kuptim, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit se Komisioni Disiplinor në mënyrë të kundërligjshme ka klasifikuar shkeljen dhe në mënyrë të kundërligjshme ka shqiptuar masën disiplinore, janë të pabazuara.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i vendimit të kundërshtuar me ankesë vërën se i njëjti ju referohet pesë (5) zyrtarëve, ku të gjithë janë shpallur përgjegjës duke ju shqiptuar masa disiplinore veç e veç, kështu që refuzimi i ankesës A.nr.638/2022 e datës 21.07.2022 dhe lënia në fuqi e Vendimit KD.Nr.011,12,013/2022 të datës 22.06.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka të bëjë vetëm me pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.638/2022

Avdyl BEKTESHI

Avdyl Bekteshi
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesve
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.